VENDIM
Nr. 371, datë 21.6.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 270, DATË 2.5.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË SUDANIN E JUGUT (UNMISS)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të aktit normativ nr. 1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)", miratuar me ligjin nr. 23/2019, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1, data "15.3.2023" ndryshohet dhe bëhet "15.3.2024";

b) Në pikën 3 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Në shkronjën "a", togfjalëshi "... 8 000 (tetë mijë) ..." zëvendësohet me "... 12 000 (dymbëdhjetë mijë) ...";

ii. Pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"ç) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku